



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 73

Prishtinë, më 11.6.2010, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

P R O C E S V E R B A L
nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naim Maloku, Zulf Merxha, Elheme Hetemi, Selvie Halimi, Ali Lajçi, Zef Morina, Berat Luzha.

Mungoi : Naser Rugova, Myrvete Pantina, Branislav Grbić, Heset Cakolli.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : Anëtarët e propozuar për Bord, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar.

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Naim Maloku**, nënkryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 8.6.2010,
3. Debatimi me të propozuarit nga Qeveria për Bordin e mjedisit,
4. Të ndryshme.

1. Nënkyetari përshëndeti mysafirët e nderuar, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e **rendit të ditës**, për çka propozoi të shtohet pika për vizitën në Bruksel, për të cilat nuk kishte vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 8.6.2010

Nënkyetari konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar me vërejtjen e **Elheme Hetemit** në diskutimin e saj lidhur me projektligjin në shqyrtim si vijon : **“Projektligjin në fjalë me ndryshime ne nuk e kemi pa dhe nuk e dimë çfarë ndryshon dhe për këtë ndoshta duhet të kthehet”**.

3. Anëtarët e propozuar për Bordin Mjedisor

Fillimisht **Naim Maloku** konsideroi se pika e rendit të ditës ka qenë dasht të formulohet **Shqyrtimi i propozim vendimit të Qeverisë lidhur me Bordin Mjedisor dhe takimi i komisionit me anëtarët e propozuar**. Ai njoftoi se dy kandidatët Behxhet Mustafa dhe Kemail Bislimi kanë arsyetuar mungesat dhe vazhdoi me leximin e dy vendimeve, nga Qeveria dhe përfundimin e Kryesisë së Kuvendit. Pasi që në komisione rrallë praktikohet kjo mënyrë e punës me kandidat të propozuar ai hapi diskutimin lidhur me anëtarët e propozuar duke propozuar që së pari të dëgjohen veç e veç secili anëtarë me një prezantim të shkurtër. **Berat Luzha** mendoj ndryshe lidhur me takimin e sotëm ngase si tha ai komisioni duhet të procedoi vetëm kalimthi propozim-vendimin e Qeverisë e jo të thellohet me marrje në pyetje të kandidatëve, pastaj të rekomandoj kuvendit miratimin. Së paku deri tani nuk është praktikuar kështu, tha ai.

Naim Maloku shprehu mirëkuptimin për brengën e z. Luzha por arsyetoi këtë ftesë për anëtarët e propozuar për shkak të vërejtjeve të shpeshta që dëgjohen se komisionet nuk shqyrtojnë këto propozime nga Qeveria dmth praktika na ka shtyrë të veprojmë ashtu si kemi veprua sot, përndryshe ai tha se janë tre mundësi : 1. komisioni të nxjerr përfundim që nuk është unik 2. kandidatët nuk i plotësojnë kushtet me ligj dhe 3. Vendimi i Qeverisë është e bazuar (e arsyeshme).

Elhame Hetemi vlerësoi se kemi të bëjmë me një përvojë të re, ndaj ishte e mendimit se takimi i sotëm është një ftesë për bashkëpunim e jo aq shumë për vlerësim, mirëpo pasi që vlerësimi profesional kërkon atëherë sugjeroi të dëgjohen kandidatët se me çfarë fusha kanë të bëjnë.

Naim Maloku rikujtoi anëtarët e komisionit se mandati i komisionit është për me vlerësua, ngase edhe grupi parlamentar ku është ai në njëfarë mënyre është i obliguar ta dëgjoj zërin e tij ngase vjen prej komisionit funksional për një çështje të caktuar (**Zylfi Merxha** plotësisht u pajtua lidhur me këtë).

Zef Morina gjithashtu konstatoi se vlerësimi i këtij komisioni ka vleftë, ndërsa për takimin e sotëm tha se më tepër do të jetë kolegjiale.

Selvie Halimi arsyetoi plotësisht ftesën e bërë anëtarëve të propozuar ngase komisioni duhet të ketë qasje dhe të njihen mes vedi me anëtarët e Bordit, ndaj ajo konstatoi se mbledhja e sotme është një takim njohës.

Berat Luzha tha se takimi kishte pas rëndësi por pasi të zgjidhen nga Kuvendi, sepse atëherë do të bisedohej për detyrat që na presin. Pos kësaj ai tha se dy kandidat nuk janë këtu, a është kjo pengesë apo çfarë.

Zylfi Merxha pyeti a duhet të epet pëlqimi për të gjithë nga lista apo vetëm për disa (për të gjithë tha kryesuesi), megjithatë kërkoi unitet në komision ngase kandidatët janë në nivel, aq sa ka mundur të lexoj shkresat.

Ali Lajçi arsyetoi qëndrimin e komisionit se duhet të njihet me anëtarët e bordit thjesht për qasje vizuale e pastaj edhe për çështje tjera të rëndësishme.

Në vazhdim morën fjalën anëtarët e propozuar të Bordit Mjedisor **Luan Shllaku, Sylejman Berisha Nysrete Doda, Islam Fejza dhe Tush Marku** të cilët prezantuan secili veten ashtu si janë shënuar nëpër CV-të e tyre pas të cilave prezantime **Naim Maloku** kishte vetëm një pyetje : a jeni të njoftuar me kompetencat që i keni sipas ligjit për mjedis. Pikërisht kjo pyetje hapi pastaj edhe një debat lidhur me vërejtjet ose pengesat që presin Bordin, p.sh. **Tush Marku** potencoi buxhetin dhe shumë mangësitë që i ka ligji në fuqi për këtë bord, por **Naim Maloku** u kundërpërgjigj se pikërisht për këto çështje është ky komision i cili do ti shtyjë këto çështje përpara duke u kujdesur që bordi të punoj në drejtimin e instalimit të praktikës së ligjeve të mira mjedisore, ai në vazhdim kërkoi edhe ndihmën nga ky bord lidhur me projektligjin në procedurë për mbrojtjen e natyrës, kërkesë kjo që shtyri **Luan Shllakun** të pyes për detyrat e Bordit të cilat menjëherë në fillim duhet të hartohen. **Blerim Vela** japi ca sqarime ligjore sipas kërkesës së kryesuesit lidhur me nevojën e dhënies së mendimeve nga

ekspertët mjedisor (në rastet e VSM etj). **Zef Morina** tha se ky bord është i pavarur dhe shprehu mendimin se do të ketë buxhet të mjaftueshëm, propozoi të miratohet propozim vendimi i qeverisë për emërimin e këtyre anëtarëve ngase është bord tepër i nevojshëm për Kosovën. **Selvie Halimi** apeloj mos të përsëritet praktika sikurse me këshillin e ujërave edhe pse ligji fatkeqësisht nuk jap kompetenca të mjaftueshme për çka propozoi që të epen sugjerimet për ndryshimin e ligjit mjedisor në vazhdimin e punës së komisionit. Lidhur me pagesa ajo (dhe shumica e anëtarëve si **Berat Luzha, Elheme Hetemi, Zylfi Merxha**) tha se nuk janë aspak në rregull sepse janë të vogla, mirëpo shprehu besimin se do të dominoj “patriotizmi mjedisor”. **Tush Markaj** kërkoj falje nëse është kuptuar për pagesë të anëtarëve të bordit, ngase fjalën e ka pasur për buxhetin i cili do ti shtyjë përpara problemet mjedisore. Të tjerët anëtarë të propozuar të bordit u angazhuan që pas emërimit nga Kuvendi duhet të mbahet një takim i veçantë lidhur me problemet që presin bordin bashkërisht me komisionin, për çka u pajtua plotësisht edhe komisioni. **Naim Maloku** sugjeroi për rekomandimin komplet për të gjithë anëtarët e propozuar, edhe pse munguan dy nga të ftuarit, ndaj komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

1. I rekomandohet mbledhjes plenare miratimi i propozim vendimit të Qeverisë lidhur me anëtarët e Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit.

2. Në mbledhjen e radhës komisioni do të shqyrtoj listën për Këshillin e Planifikimit Hapësinor duke i ftuar të propozuarit nga Qeveria : Ruzhdi Pllana, Ylber Vokshi, Ilir Gjinolli, Laura Kusari-Limaj, Xhelal Llonçari, Dervish Qerreti dhe Adem Pajaziti.

4..Të ndryshme

Naim Maloku njoftoi për shtyrjen e vizitës në Bruksel, ndërsa komisioni nxori :

K O N F I R M I M **Për Kryesinë e Kuvendit**

Komisioni parlamentar për bujqësi dhe mjedis pasi që paraprakisht u sugjerua nga donatori i vizitës, njofton kryesinë e Kuvendit se për shkaqe tekniko-logjistike, vizita e paraparë në Bruksel për dt.14-18 qershor shtyhet për **21-23 qershor 2010** si vijon :

- agjenda përafërsisht e ngjashme,
 - për ndërrimin eventuale të ndonjë anëtari do të njoftohen departamentet përkatëse, ndërkaq mbetet numri i njëjtë i delegacionit udhëhequr nga kryetari **Naser Rugova**, duke paguar eventualisht ndonjë vizë nga buxheti i Kuvendit për anëtarin që është ndërruar dhe nuk e ka,
 - për çështje tjera mbetet ashtu si është vendosur paraprakisht sipas vendimit të Kryesisë nr. 03-V-302 nga dt. 1 qershor 2010,
- Kërkohet nga sekretaria e Kuvendit të procedoi këtë njoftim Kryesisë së Kuvendit për shtyrje të vizitës dhe të arkivohet bashkërisht me vendimin e lartcekur të Kryesisë.

U konstatua zëvendësimi i anëtarit të delegacionit **Zylfi Merxha me Zef Morinën** i cili duhet të deponoj pasaportën të hënën në protokoll nëse nuk ka vizë.

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,50.

Nënkryetari i Komisionit,
Naim Maloku

